

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 28 PRILL 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Përpara se të hyj në thelbin e çështjes së temës së diskutimit të ditës së sotme, që është një fushë shumë delikate, zemra e funksionimit të një rendi demokratik, të një qeverisje demokratike, që ka të bëjë me informimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, desha te them se, sigurisht, nuk e kuptoj dot sesi kolegë deputetë të opozitës (këtë e them me ironi, nuk e them në mënyrë polemike), i kërkojnë përgjegjshmëri Kryeministrit të vendit! Nuk arrij ta kuptoj dot pse e bëjnë këtë gjë. Ky njeri foli qartë dhe në fjalën e fundit tha: “Me Butrintin bëjmë ç’të duam ne”. Në imagjinatën e këtyre Shqipëria është pronë e këtyre, nuk është kjo gjëja e madhe, e përbashkët që ka administratorin e radhës, që është qeveria e radhës, po është pronë e tyre.

“Është e imja, - tha - bëj çfarë të dua vetë”. Kjo është pjesa e parë. Pjesa e dytë. Në lidhje me thirrjen që u bë, nuk bashkohem me kolegun Tritan Shehu, i cili kërkon etikë në sallën e Parlamenti nga njerëz që rekat psikike të tyre duan t’i sistemojnë në këtë sallë. Nuk sistemohen turbullirat psikike këtu, absolutisht, jo. As paranojat nuk zgjidhen këtu, zgjidhen diku tjetër, por kur ngërçi është shumë i madh në fytyrë, paranojat vetëm shtohen. Kështu që, kërkesa juaj, zoti Shehu është pa vend. Ai do të vazhdojë të jetë një rekkë psikologjike dhe këta do të jenë ca njerëz të pafuqishëm, të trembur, që nuk mbajnë dot standard të barabartë parlamentar. Një fjalë e thënë nga opozita rëndon, është plumb, kurse fjala dhe ofendimi i thënë nga një i turbulluar psikikisht, është pupël e lehtë, këtu kuptohet se cili është edhe funksionimi i Rregullores, edhe funksionimi i këtij Parlamenti.

Megjithatë, të rrimë te thelbi i çështjes. Ky që foli një gjysmë ore këtu për Butrintin dhe për historitë e tij të plaçkitjes së pasurisë kulturore, ky që u shqetësua se është në gjyq për bingot e teatrit, nuk shqetësohet për 2 miliardë euro që ka nëpër arbitrazhe, ku nga 150, 200 dalin përditë. Ky e ka hallin te gjyqi që ka për bingon e teatrit. Ky është interesi publik që ka në mendje. Sot duhet të fliste për një gjë shumë të madhe, pasi ne jemi në momentin e një skandali më të rëndë, praktikisht të një shteti të rënë, ku miliona të dhëna personale nga të dhënat personale të identitetit, 900 e ca mijë të dhëna, qindra dhe

mijëra të tjera që kishin të bënin me rrogat, targat e makinave, numrat e telefonit, numrat e kartave të identitetit, miliona të dhëna janë sheshit që të gjitha.

Sigurisht që këtij i intereson të jenë sheshit, të përdoren e të shpërdoren si të duan, sepse sot garanci se çfarë do të bëhet me këto të dhëna nuk ka asnjë. Me të drejtë Komisioneri bëri referimet e tij në raportin rutinë të vitit, por a mbajti mend njeri këtu se kush u mor në përgjithësi? A ka përgjegjës kjo? Se veçili i këtyre të dhënave është shteti që i merr? Shteti dje duartrokiti që digjitalizimi arriti nivele të jashtëzakonshme, edhe unë e përcolla entuziazmin infantil të disa kolegëve, ata ose janë infantil vërtet ose do t'i bëjnë freskun e radhës Kryeministrit. Cilat të dhëna po digjitalizojmë, këto që janë sheshit, siç ikën këto miliona e miliona të dhëna të tjera? Ky është shërbim i digjitalizuar me zero siguri.

Çfarë është, apo pasje e të dhënave që ky Big Brother-i mund t'i përdorë si të dojë, të shantazhojë kë të dojë e të ketë gjithçka në duar për të bërë si të dojë? Si mund të flasim sot për digjitalizim kur nuk u kemi dhënë ende përgjigje këtyre të dhënave, tashmë të ruajtura në mënyrë elektronike, të cilat kanë marrë dhenë? Në memorien e shqiptarëve ka mbetur vetëm një gjë, që për të gjithë këtë krim shtetëror të mirëfilltë vetëm 2 gazetarët, Andi Bushatin dhe Armand Shkullakun, kanë në mendje shqiptarët. Ku janë ata që kanë detyrimin t'i mbrojnë këto të dhëna, t'i ruajnë, që kurrën e kurrës të mos jenë në dorë të Zotit, sepse ne jemi të certifikuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, meqenëse proamerikanizmi është në modë sot? Departamenti Amerikan i Shtetit thotë: "Shqipëria shërben si bazë për krimin e organizuar në Amerikë, në Europë, në Lindjen e Mesme, në Amerikën Latine".

Ky krim i organizuar ka miliona të dhëna nëpër duar dhe nuk ka fajtorë shtetërorë. Atëherë, ka vetëm një shpjegim, i palëvizshëm ky shpjegim, që drejtësia e kapur, shteti i kapur nga krimi dhe nga trafikantët kërkojnë që këto të dhëna t'i kenë ata dhe të bëjnë si të duan dhe qytetarët të jenë të pambrojtur, sepse një shtet tjetër do ta kishte bërë natën ditë dhe këtu do të kishim raportime pa fund, marrje të përgjegjësive, si ishin dënuar, si kishte rrjedhur, si ishin marrë masat ekstreme që ky informacion të mos kishte dalë më kurrë, por deri tani asnjë nga këto. Ditën kur do të diskutohej për këtë skandal dhe krim shtetëror të mirëfilltë, siç ju thashë, dëgjuam rekat psikologjike të të çarturit, i cili po na tregonte që Butrinti është imi. Do ta marrë me vete ky Butrintin, se këtyre me halucinacione besoj se do t'u ketë thotë ndonjëri që do të jetoni 400 vjet, por nuk e dinë që Perëndia është e drejtë me të tërë, është superdemokratike, aq e kanë ymrin që të gjithë. Asnjë fjalë për këtë çështje.

Sot do të dalë nga ky raport dhe do të votohet një rezolutë. Por çfarë thotë për këto të dhëna, ku janë përgjegjësitë, këto dhjetëra dhe mijëra shërbime të digjitalizuara? Në dorë të kujt janë? Apo prapë do të

dalë që fajtor është gazeta filan, portali filan, filan dhe filan. Ata ua dinin të tëra njerëzve, me çfarë paraqitet individ, çfarë numri telefoni ka, çfarë karte identiteti, me çfarë mund ta hapin llogarinë, çfarë të duan mund të bëjnë në emër të njerëzve të caktuar me to, sepse në dorë i kanë dhe nuk kanë më nevojë t'i kenë fizikisht dhe këtu nuk ka ndodhur asgjë. E njëjta gjë ndodh pastaj edhe për një sektor tjetër të madh, të asaj që quhet "qeverisje demokratike", por që veçse demokratike nuk është dhe lidhje nuk ka, e drejta e informimit. Po për çfarë të drejte informimi po flasim ne?

Ne themi t'u garantojmë të drejtën e informimit qytetarëve. Ne kemi deputetë dhe kemi 2 mundësi që ta mbështesim të drejtën tonë për informim, ligjin "Për statusin e deputetit" dhe ligjin "Për të drejtën e informimit". Unë kam një rast më të fundit këtu, kur kam kërkuar informacion, por informacioni nuk vjen, përtej të gjitha afateve ligjore. I jam drejtuar edhe Kryetares së Kuvendit, edhe zotit Dervishi, si dhe kam kërkuar të merren masa administrative, ashtu siç e kërkon ligji, sepse refuzojnë informimin për çështje të interesit të lartë publik. Çfarë ndodh? Me qetësinë më të madhe nuk informojnë, pra nuk informojnë as deputetët. A mendoni ju se e drejta e informimit në këtë vend është garantuar për të tjerët? Cili është dimensionet që ka marrë e drejta e informimit? Është shumë interesante.

Kemi kontrata, koncesione sekrete, blejmë vaksina me kontrata sekrete. U bë këtu një debat goxha i madh nga zonja Zhupa për Butrintin, edhe ajo jo me të gjitha dokumentet e plotësuar, sepse edhe atje ka pjesë sekrete konfidenciale. Këto sekretet e mëdha për të batërdisur interesin publik i dinë vetëm këta dhe nuk mund t'i ndajnë me të tjerët, janë shumë sekret, por a do t'i paguajnë shqiptarët, sepse janë taksat. Por këta edhe për taksat e shqiptarëve thonë "janë tonat". Ju e keni dëgjuar shprehjen që "këto do t'i paguajë qeveria", "këto i bën qeveria", sepse qeveria ka një portofol të vetin, nuk është portofoli ynë ai që e paguajmë të gjithë ne, por është i qeverisë portofoli. Edhe këto të dhëna janë sekrete, edhe tenderat që prokurohen me 8- fishin apo 10-fishin e çmimit edhe ato sekret janë.

U kthym në kohën e sekreteve në momentin që informimi duhet të ishte në apogjeun e vet. E pra, sot në këtë moment ku raportohet për këto dy çështje të mëdha, sinqerisht do t'ju them se nuk do ta votoj projektrezolutën, jo për shkakun e mosvotimit të një dokumenti rutinë, por sepse dy çështjet madhore mbrojtja e të drejtave dhe të dhënave personale dhe e drejta e informimit janë në momentin e tyre më dramatik si kurrë më parë në këtë pluralizmin tonë të gjatë apo të shkurtër, quajeni si të doni. Ndaj, sot për sa kohë "fajtorët" e vetëm vazhdojnë të mbeten Andi Bushati dhe Armand Shkullaku dhe asnjë veqil i shtetit, gjithë kjo farsë nuk i shërbeu askujt, por tregoi që ajo do të përsëritet sërish e sërish për fat të keq. Faleminderit!